

**Vendim nr. 203 datë 30.09.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 30.09.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 7 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:** VALENTINA TROJA

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 606, datë 02.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 997, datë 27.04.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2024-1713, datë 24.04.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

## Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja Valentina Troja së bashku me familjarët e saj, prindërit dhe vëllain R.T., (paditës në gjykim) kanë jetuar në të njëjtin apartament me sipërfaqe 61,3 m<sup>2</sup>, në qytetin e Tiranës. Pallati në të cilin jetonin ka pasur edhe një sipërfaqe bodrum, i cili ishte i ndarë për të gjithë banorët dhe apartamentit të cituar i përkiste sipërfaqja 12 m<sup>2</sup>. Kërkuësja së bashku me prindërit kanë qenë të regjistruar si një familje në Zyrën e Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, ndërsa i vëllai, së bashku me bashkëshorten e tij L.T. (paditësja tjetër në gjykim) kanë qenë të regjistruar si një familje e veçantë. Pavarësisht këtij fakti, ata kanë jetuar të gjithë në një apartament.

2. Në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”(ligji nr.7652/1992) kërkuësja së bashku me prindërit, në cilësinë e qiramarrësve të banesës kanë nënshkruar kontratën e privatizimit me ish-Ndërmarrjen Komunale të Banesave për apartamentin. Privatizimi i banesës është regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 125, datë 01.03.1994 të Zyres Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Tiranë. Ndërsa në datën 26.04.1994 ata kanë nënshkruar kontratën e privatizimit nr. 48921 rep., nr. 16311 kol., (kontrata nr. 48921/16311) për bodrumin me sipërfaqe 12 m<sup>2</sup>, e cila është regjistruar në regjistrin hipotekar nr. 146, datë 13.05.1994 të ZVRPP-së, Tiranë. Prindërit e kërkuësës, me kontratën e dhurimit nr. 1676 rep., 410 kol., datë 24.04.1996 (kontrata nr. 1676/410) ia kanë dhuruar pjesën e tyre takuese kërkuësës.

3. Kërkuësja ka lidhur me shtetasin D.B. kontratën e shitjes nr. 4233 rep., nr. 1020 kol., datë 16.06.2012 (kontrata nr. 4233/1020) për pasurinë bodrum. Ndërsa në vitin 2014 shtetasi D.B. ka lidhur me shtetasen Q.Sh. kontratën e shitblerjes nr. 171 rep., nr. 39/1 kol., datë 13.01.2014 (kontrata nr. 171/39/1) për të njëjtën pasuri.

4. Shtetasit R.T., dhe L.T. (paditësit), me pretendimin se ishin përjashtuar padrejtësisht nga privatizimi i pasurisë bodrum, i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke paditur kërkuësën, shtetasit D.B., Q.SH., si dhe drejtorinë nr. 3 të punëtorëve të qytetit Tiranë me padi me objekt: i) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratave të shitjes nr. 48921/16311 për pasurinë bodrum dhe të dhurimit nr. 1676/410; ii) konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes nr. 4233/1020 të lidhur mes kërkuësës dhe shtetasit D.B., si dhe të kontratës nr. 171/39/1..

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 606, datë 02.02.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe detyrimin e të paditurve, kërkuësës dhe shtetasve D.B., dhe Q.Sh. për të njohur paditësit, shtetasit R.T., dhe L.T., bashkëpronarë në 1/5-ën pjesë secili për pasurinë bodrum, si rezultat i konstatimit të pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike. Gjykata e

Rrethit Gjyqësor Tiranë, në mënyrë të përmbledhur, ka arsyetuar se paditësit kanë jetuar në të njëjtin mjedis me të paditurën dhe kanë të njëjtat të drejta bashkëpronësie të rrjedhura nga ligji nr. 7652/1992, të cilat janë zgjidhur përfundimisht me një vendim gjyqësor të formës së prerë nr.1441, datë 17.04.1998 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pasurinë apartament. Ky vendim gjyqësor është detyrues për gjykatën lidhur me faktet e parashtruara dhe të njohura si të tilla përfundimisht në të. Sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si pala paditëse dhe e paditura janë bashkëpronarë të apartamentit dhe të bodrumit, privatizimi i të cilëve ka të njëjtin shkak ligjor, faktin që kanë jetuar në të njëjtin mjedis.

6. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur ankim kërkuesja. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 997, datë 27.04.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 606, datë 02.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7. Pas rekursit të ushtruar nga kërkuesja dhe i padituri tjetër Q.Sh., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-1713, datë 24.04.2024, ka vendosur mospranimin e tij, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

8. Në datën 19.06.2024 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 25.06.2024.

## II

### Pretendimet e kërkueses

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet objekt kundërshtimi i kanë cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

9.1. *Parimit të paanshmërisë*, pasi gjykatat nuk kanë marrë parasysh provat e paraqitura, por kanë mbështetur paditësen, e cila është me profesion juriste dhe për këtë shkak Gjykata e Lartë ka vendosur në favor të saj.

9.2. *Së drejtës së pronës*, pasi gjykatat nuk kanë marrë parasysh se pala e ditur ka fituar të drejtën e pronësinë nëpërmjet dokumenteve të falsifikuara, të provuara me aktin e ekspertimit.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

11. Kolegji vlerëson se kërkuësja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Për rrjedhojë, ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

13. Kolegji vlerëson se kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 24.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 19.06.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione materiae*, Kolegji vlerëson se nisur nga thelbi i argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, ato lidhen me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të parimit të paanshmërisë dhe së drejtës së pronësisë.

15. Për pretendimin e parimit të paanshmërisë kërkuësja ka pretenduar se gjykatat kanë vendosur në favor të palës së paditur, për shkak të profesionit të saj si juriste. Kolegji vlerëson se

argumentet e parashtruara nga kërkuesja nuk janë në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e ndonjë të drejte kushtetuese, për rrjedhojë pretendimi nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Kolegji konstaton se në lidhje me cenimin e së drejtës së pronësisë, kërkuesja ka pretenduar se pala e paditur e ka fituar të drejtën e pronësisë të pasurisë bodrum, duke u paraqitur me dokumente të falsifikuara.

17. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyt atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këndvështrim të standardeve kushtetuese, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkueses për cenimin e së drejtës së pronësisë kanë të bëjnë me vlerësimin e provave nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për rrjedhojë nuk hyjnë në sferën e juridiksionit kushtetues dhe nuk mund të merren në shqyrtim.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.